



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Analizë e investimeve kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë - viti 2019

***Ky dokument është hartuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio Ekonomike
Rajonale në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.***

Ky publikim është një përmbledhje e të dhënave të mbledhura nga ministritë e linjës dhe komunat lidhur me investimet kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore gjatë vitit 2019

Përmbajtja:

Shkurtesat	4
Përkufizime:	5
II. Përmbledhje ekzekutive	6
III. Metodologjia.....	7
IV. Thirrjet për projekt propozime të publikuara nga Ministritë e linjës	8
V. Investimet e përgjithshme kapitale në vitin 2019 sipas ministrive të linjës në rajonet zhvillim ore	8
VI. Investimet e përgjithshme kapitale në vitin 2019 sipas sektorëve në rajonet zhvillimore ..	9
VII. Projektet në partneritet të realizuara nga dy e më shumë komuna.....	11
VIII. Informacion i përgjithshëm mbi pesë (5) rajonet zhvillimore rajonale	11
IX. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Qendër.....	15
X. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Lindje.....	19
XI. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Veri	23
XII. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Perëndim	27
XIII. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Jug.....	31
XIV. Investimet kapitale për kokë banori nga niveli qendror sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore në Kosovë	35
XV. Investimet kapitale vetanake të realizuara nga komunat.....	39
XVI. Investimet kapitale vetanake të realizuara nga komunat për kokë banori për pesë (5) rajonet zhvillimore	46
XVII. Zhvillimi rajonal i balancuar në vitin 2019.....	50
XVIII. Konkluzione dhe Rekomandime.....	53
Referencat:	57

Shkurtesat :

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument janë si vijon:

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MF	Ministria e Financave
LMFPP	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
LFPL	Ligji Nr. 03/L-049 për Financa të Pushtetit Lokal
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 - 2021
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
OB	Organizata Buxhetore
KASH	Korniza afatmesme e shpenzimeve

Përkufizime:

»**Rajon zhvillimor**« është territor funksional për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, të inkomporuara, me vendbanime, ekonomike, infrastrukturore dhe sisteme natyrore të balancuara, në një bashkësi hapësimore pa dallime ku mundësitë e barabarta për zhvillim të balancuar rajonal mund të jepen;

»**Zhvillimi rajonal**« është një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone;

»**Pabarazi rajonale**« është gjendje kur në mes rajoneve të caktuara kemi dallime substanciale në krahasim me rajone të tjera në disa indikatorë socio-ekonomik (GDP/Capita; investime për kokë banori; niveli i papunësisë etj.) por jo vetëm;

»**Zhvillimi i balancuar rajonal**« procesi i uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik dhe cilësisë së jetës në rajone të ndryshme;

»**Politikat për zhvillim rajonal**« japin kornizën e zhvillimit rajonal dhe intervenimeve në fusha specifike të cilat do të drejtohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal;

»**Strategjia Kombëtare për Zhvillim**« është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror;

»**Korniza afatmesme e shpenzimeve**« paraqet dokument kryesor mbi bazën e të cilit hartohet buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë;

»**Projekt Kapital**« – një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet, sipas kritereve të përcaktuara, ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale.

I. Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin e saj ligjor të përcaktuar me shtojcën 16 të Rregullores (QR) Nr. 07/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e punës për vitin 2020, ka përgatitur "Analizën e investimeve kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë për vitin 2019".

Përmes këtij dokumenti, MZHR synon të pasqyrojë investimet kapitale të realizuara nga Ministritë e linjës në pesë (5) rajonet zhvillimore në Kosovë gjatë vitit 2019: Qendër, Lindje, Veri, Perëndim, Jug. Sa ishte shuma e investimeve kapitale të shpërndara nga Ministritë e linjës gjatë vitit 2019, cilat ishin ato ministri që financuan më së shumti apo më së pakti projekte kapitale në komuna, cili ishte rajoni zhvillimor dhe komuna që përfitoj më së shumti apo më së pakti investime kapitale nga M.L, këto investime në cilët sektorë u shpërndan dhe cilët ishin ata sektor që përfituan më së shumti dhe më së pakti, sa ishte shpërndarja e balancuar e investimeve ndërmjet rajoneve, etj. Pra, këto janë vetëm disa nga pyetjet që gjejnë përgjigje në këtë dokument, e që të gjitha i nënshtrohen një krahasimi me vitin paraprak 2018.

Për dallim nga analiza e investimeve kapitale të viti të kaluar 2019 për vitin 2018, në Analizën e investimeve kapitale të përgatitur në vitin 2020 për vitin 2019, është trajtuar edhe një element i ri, janë pasqyruar edhe investimet kapitale të komunave, pra nga vet buxhetet e tyre. Janë nxjerrë edhe sektorët ku vetë komunat kanë realizuar projekte kapitale gjatë vitit fiskal 2019. Janë trajtuar edhe projektet e realizuara në partneritet ndërmjet komunave, që në fakt janë në numër minimal e në këtë aspekt mbetet që MZHR të fokusohet më shumë me qëllim të nxitjes së bashkëpunimeve të komunave brenda rajoneve.

Trajtimi i të gjitha investimeve kapitale (qendrore dhe lokale) është bërë marrë parasysh projektet e financuara që i përkasin sektorëve publik/infrastrukturës publike lokale dhe rajonale, përgjithësisht që ndërlidhen me përmbushjen e kompetencave vetanake të komunave të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale.

Bazuar në udhëzimin administrativ të Ministrisë së Financave, nr.04/2019, investimet kapitale kanë ndikim të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik të vendit apo/dhe arrijnë e objektivave strategjike të organizatave buxhetore. Investimi kapital pritet të ofrojë përmirësim ose përfitim të ri siç janë zgjerimi i kapacitetit, ulja e shpenzimeve apo përfitime të ngjashme si dhe investimi pritet të ofrojë përfitime gjatë shumë viteve.

Për përgatitjen e kësaj analize është marrë për bazë: Raporti i Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale për vitin 2019 i Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, si dhe janë marrë parasysh të dhënat dhe komentet e pranuar nga ministritë e linjës dhe komunat.

II. Përmbledhje ekzekutive

Planifikimi i mirë i investimeve kapitale është thelbësor për menaxhimin e efektshëm të buxhetit nga një organizatë buxhetore.

Për planifikimin e mirë të investimeve kapitale, e rëndësishme është të merren parasysh analizat dhe vlerësimet mbi investimet e realizuara në vitet e kaluara, nevojat ekzistuese të

komunitetit, shpërndarja e balancuar e investimeve qendrore në ato lokale, si dhe përmbushja e prioriteteve të përcaktuara paraprakisht.

Përmes përgatitjes dhe publikimit të kësaj analize, MZHR synon të ndihmojë duke ofruar një burim të rëndësishëm për planifikim dhe koordinim të investimeve kapitale për periudhën e ardhshme, sidomos nga niveli qendror për nivelin lokal. Kjo analizë, trajton hollësisht shpërndarjen e investimeve kapitale të ministrive të linjës gjatë vitit 2019, në raport me pesë (5) rajonet zhvillimore: Qendër, Lindje, Veri, Perëndim dhe Jug. Paraqiten diferencat ndërmjet rajoneve dhe komunave në aspekt të pranimit të përkrahjes për realizimin e projekteve kapitale gjatë një viti. Promovohen llojet e investimeve të realizuara nga ministrinë e linjës në komuna, jepet mundësia e vlerësimit të ndërlidhshmerisë së këtyre investimeve me mandatin e vetë ministrive.

Marrë parasysh mandatin e MZHR-së dhe vizionin e saj për promovimin e zhvillimit rajonal të balancuar, pasqyrimi i investimeve kapitale në këtë dokument bëhet në Rajon zhvillimor, duke i konkretizuar pastaj në komunat përkatëse të një rajoni, numrin e projekteve, sektorët dhe shpërndarjen e investimeve nëpër komuna. Analiza jep përgjigje se cili Rajon zhvillimor në Kosovë ka pranuar më së shumti investime kapitale nga ministrinë e linjës në vitin 2019, në vlerë të shumës totale si rajon.

Përmes kësaj, synohet të promovohet zhvillimi rajonal i balancuar/barabartë, duke ndikuar në zvogëlimin e dallimeve që ekzistojnë midis rajoneve të ndryshme apo rajoneve më pak të zhvilluara në aspektin socio-ekonomik. Shumë komuna të vogla varen në masë të madhe nga buxheti qendror (Granti qeveritar) dhe investimet e ministrive të linjës. Mos përfshirja e tyre në skemat e përkrahjes me investime kapitale, ndikon absolutisht në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik lokal të tyre. I

III. Metodologjia

Analiza është hartuar duke marrë për bazë Raportin e Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale për vitin 2019 të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave.

Janë marrë për shqyrtim edhe listat e projekteve kapitale 2019 të pranuar nga ministrinë e linjës, si dhe komentet e pranuar me shkrim nga komunat. Pasqyrimi i të dhënave lidhur me investimet kapitale të nivelit qendror në rajonet zhvillimore, janë paraqitur duke i grupuar në nivel të rajonit zhvillimor, pastaj duke i konkretizuar në komuna.

Është realizuar komunikim i vazhdueshëm me përfaqësuesit e Ministrive të linjës (ML), janë konsultuar drejtoret për zhvillim ekonomik të komunave si dhe janë marrë për bazë sugjerimet e përfaqësuesve të 5 (pesë) agjencioneve zhvillimore rajonale (AZHR-ve).

Analiza është hartuar nga Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.

Ekipi i angazhuar për hartimin e dokumentit është si vijon:

- Hartuar dhe mbikëqyrur nga z. Blerim Hasani, Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale.
- Hartuar nga znj. Vjendita Avdiu Musliu, Udhëheqëse e Divizionit për Zhvillim Rajonal të Balancuar.
- Ndihmuar nga znj. Vlora Fetoshi, Zyrtare për Zhvillim Socio – Ekonomik.

IV. Thirrjet për projekt propozime të publikuara nga Ministrinë e linjës

Komfor legjislativ në fuqi, të gjitha institucionet qoftë të nivelit lokal apo qendror, janë të obliguara të respektojnë parimin e transparencës më rastin e shpenzimit të parasë publike. Ministrinë shpallin thirrje dhe lansojnë programe për shpërndarjen e investimeve kapitale në nivel lokal. Me qëllim të pasqyrit të formave të njoftimit publik të komunave për aplikim me projekt – propozime, kemi hulumtuar faqet zyrtare të dymbëdhjetë (12) ministrive.

Nga dymbëdhjetë (12) ministri kemi arritur të identifikojmë vetëm 2 ministri të cilat kanë publikuar thirrjet për aplikim për vitin 2019 në web faqet e tyre:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me programin e titulluar: Projekte të Bashkëpunimit ndër komunal të infrastrukturës socio - ekonomike për përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve, e publikuar me datë 27.02.2019.
- Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka publikuar thirrjen me titull: "Programi për Zhvillim Rajonal 2019 – Përkrahje komunave për avancimin e infrastrukturës publike" i publikuar me datë 14.01.2020.

V. Investimet e përgjithshme kapitale në vitin 2019 sipas ministrive të linjës në rajonet zhvillimore

MZHR ka trajtuar investimet kapitale të dymbëdhjetë (12) ministrive të linjës. Buxheti total i investuar nga ministrinë e linjës në komuna për vitin 2019, është 94,081,060.89€. Numri i projekteve të investuara është 564 .


Për dallim nga viti 2018, në vitin 2019 kemi ngritje të investimeve kapitale të realizuara nga Ministrinë e linjës. Në vitin 2018, financimi ishte në shumë prej 75,787,058.16 dhe me numër të projekteve 438. Diferenca e vitit 2019 me 2018 është 18,294,002.73 apo 11% më shumë, ndërsa numri i projekteve më shumë të financuara është 126.

Ministrinë e linjës dhe totalët e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2019, paraqitën si në tabelën në vijim.

Tabela 1, Investimet e përgjithshme kapitale në vitin 2019 sipas ministrive të linjës

Nr.	Ministrinë	Totali i investimeve kapitale (€)	Totali i projekteve
1.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	10,238,429.02	55
2.	Ministria e Shëndetësisë	2,636,103.72	4
3.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	2,866,345.00	51
4.	Ministria për Komunitete dhe Kthim	807,381.00	18
5.	Ministria e Administratës Publike	18,729,969.51	19
6.	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	11,799,570.79	64
7.	Ministria e Infrastrukturës	34,995,984.09	189
8.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3,448,556.00	71
9.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	630,408.20	3
10.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2,442,213.69	5
11.	Ministria e Zhvillimit Rajonal	2,010,550.53	29
12.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	3,475,549.34	56
	Totali i investimeve kapitale në Komuna/Rajone	94,081,060.89	564

Graf. 1 Vlera e përgjithshme e investimeve kapitale sipas ministrive



Sipas tabelës nr.1 dhe grafikonit nr. 1, të paraqitur më lartë, tri (3) ministritë që kanë investuar më së shumti investime kapitale në rajonet zhvillimore gjatë vitit 2019, janë:

1. Ministria e Infrastrukturës, me total të investimeve: 34,995,984.09€;
2. Ministria e Administratës Publike, me total të investimeve: 18,729,969.51€
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me total të investimeve: 11,799,570.79€

Ngjashëm sikur vitin 2018 edhe në vitin 2019, prin me investime kapitale Ministria e Infrastrukturës, e cila gjithashtu ka një diferencë të investimeve më të madhe në vitin 2019 prej vitit 2018, në shumë prej 7,149,794.14 apo 11% dhe me 34 projekte më shumë në vitin 2019 për dallim nga viti 2018

VI. Investimet e përgjithshme kapitale në vitin 2019 sipas sektorëve në rajonet zhvillimore

Çështje e rëndësishme dhe themelore e kësaj analize, është edhe trajtimi i sektorëve në të cilët janë realizuar investimet dhe të identifikuar sipas burimeve të marra për bazë. Sektorët e investimeve të cilët janë pjesë e trajtimit në këtë analizë, janë përzgjedhë bazuar në Raportin vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 i Ministrisë së financave. Tabela e mëposhtme përmbledh investimet kapitale të realizuara duke i përshkruar sektorët e trajtuar. Numri i sektorëve të trajtuar është 15 të cilët janë identifikuar duke u bazuar në përshkrimin e titujve të projekteve kapitale nga Raportin vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe listat e projekteve kapitale të pranuar nga Ministritë e linjës. Mbi këtë bazë, për dallim nga viti 2018 ku janë trajtuar 13 sektorë, në


vitin 2019 janë shtuar edhe dy (2) sektor të rinj (në total 15 sektorë) të konfirmuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik: 1) Telekomunikacioni dhe 2) Efiçienca e Energjisë. Në këtë kontekst, përcaktimi i shumës së financimit nëpër sektorë, është bërë duke marrë për bazë përshkrimin e projekteve të financuara dhe listën e sektorëve të raportit të lartshënuar.

Sektorët dhe totalët e investimeve kapitale të realizuara në secilin sektor gjatë vitit 2019, paraqitën si në tabelën në vijim:

Tabela 2, Investimet e përgjithshme kapitale sipas sektorëve

Nr.	Përshkrimi	Gjithsejtë
1.	Ndërtesat e banimit	910,408.20
2.	Ndërtesat administrative, afariste	6,911,664.30
3.	Objektet arsimore	26,152,566.36
4.	Objektet shëndetësore	2,778,148.72
5.	Objektet kulturore	3,267,638.54
6.	Objektet sportive	503,527.95
7.	Ndërtimi i rrugëve lokale	37,592,438.92
8.	Trotuaret	1,810,964.12
9.	Kanalizimi	1,194,909.80
10.	Ujësjetllësi	2,144,519.77
11.	Mirëmbajtja investive	52,431.00
12.	Telekomunikacioni	1,367,617.00
13.	Efiçienca e Energjisë	1,498,728.00
14.	Rregullimi i lumenjve	4,730,468.09
15.	Kapital tjetër	3,165,030.12
	Gjithsejtë	94,081,060.89

Graf. 2 Vlera e investimeve sipas sektorëve



Sipas tabelës dhe grafikoni nr. 2, të paraqitur më lartë, tre (3) sektorët në të cilët është investuar më së shumti gjatë vitit 2019, janë:

1. Ndërtimi i rrugëve lokale: 37,592,438.03€
2. Objektet arsimore: 26,152,566.36€
3. Ndërtesat administrative, afariste: 6,911,664.30€

Edhe në vitin 2019 sikurse në vitin 2018, prin sektori i rrugëve lokale, si sektori më i investuari në Kosovë. Investimi i vitit 2019 nga viti 2018 është më i madh në shumë prej 6,692,049.44 apo 10%.

VII. Projektet në partneritet të realizuara nga dy e më shumë komuna

Ministria e Zhvillimit Rajonal, promovon krijimin e rrjetëzimeve të komunave për realizimin e projekteve të bazuara në nevojat e përbashkëta që kanë ato. Mirëpo, fatkeqësisht në vitin 2019 është vërejtur një numër minimal për dallim na viti 2018. Projektet e investuara nga MZHR në partneritet të komunave paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela 3, projektet në partneritet

Rajonet zhvillimor e	Komuna lidere	Komuna Partnere	Emri i projektit	Propozimi
Rajoni Qendër - Veri	Glllogoc - Skenderaj		PARTICIPIMI I PROJEKTEVE	100,000.00€
Rajoni Jug	Rahovec – Malishevë		PARTICIPIMI I PROJEKTEVE	51,486.71
Total				151,486.71

VIII. Informacion i përgjithshëm mbi pesë (5) rajonet zhvillimore rajonale

Ministria e Zhvillimit Rajonal marrë parasysh mandatin e saj ligjor, të përcaktuar me shtojcën 16 të Rregullores (QR) Nr. 07/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Planin e punës për vitin 2020 është bartëse e politikave për zhvillimit rajonal, synimi i të cilave është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar në Republikën e Kosovës. Në kuadër të objektivave dhe Planit të punës për vitin 2020, Ministria për Zhvillim Rajonal ka për synim hartimin e politikave dhe dokumenteve analitike në kontekst të pasqyrimin dhe avancimit të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë.

MZHR ka hartuar Koncept – Dokumentin për Zhvillim Rajonal të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar me Vendimin Nr. 13/61 të datës 22.08.2018 dhe referuar koncept dokumentit, MZHR harton analiza dhe zhvillon politikat sipas pesë (5) rajoneve zhvillimore:

- **Rajoni Zhvillimor Qendër**
- **Rajoni Zhvillimor Lindje**
- **Rajoni Zhvillimor Veri**
- **Rajoni Zhvillimor Perëndim**
- **Rajoni Zhvillimor Jug**

Gjatë vitit 2019, MZHR ka hartuar dokumentin *Profilët Zhvillimore Rajonale* i cili dokument ka për qëllim të trajtoj specifikat rajonale që ndërlidhen me sipërfaqet në dispozicion, të dhënat dhe specifikat për popullsinë, si dhe aspektin demografik nëpër rajone. Fokus i veçantë në këtë dokument i është dhënë burimeve dhe potencialeve se ku mund të orientohet zhvillimi ekonomik, rrjedhimisht zhvillimi i balancuar ekonomik i rajoneve zhvillimore të Kosovës. Dokumenti, trajton nivelin e arsimimit të popullsisë, potencialet në fushën e sektorit të bujqësisë, sektorit të turizmit, profilet e bizneseve që operojnë brenda këtyre rajoneve, kushtet e të bërit biznes, gjithashtu edhe nivelin e infrastrukturës që është në funksion të zhvillimit. Dokumenti gjendet i publikuar në faqen zyrtare të MZHR-së në tre gjuhët zyrtare (Shqip, Serbisht dhe Anglisht) apo mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm :

Link: <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>

MZHR është në fazën e finalizimit Draft - Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030 ku janë paraparë objektivat, orientimet shumë vjeçare dhe e gjithë rregullativa e zhvillimit rajonal në Kosovë. Pas aprovimit të saj, MZHR do të filloj edhe hartimin e Ligjit të parë në Kosovë që do të rregullojë fushën e zhvillimit rajonal.

8.1 Rajoni zhvillimor Qendër, përbëhet nga 8 (tetë) komuna: Prishtina, Podujeva, Lipjani, Obiliqi, Drenasi, Shtimja, Fushë Kosova dhe Graçanica. Rajoni zhvillimor qendër kufizohet me rajonin jug në juglindje, rajonin veri në verilindje me rajonin lindje në juglindje dhe Serbinë në verilindje.

Referuar dokumentit “Profilët e Rajoneve Zhvillimore ”¹ në Kosovë që MZHR ka hartuar gjatë v.2019, rajoni zhvillimor Qendër ka një sipërfaqe prej 2,215.52 km², popullsi prej 512,398² banorëve sipas vlerësimit të popullsisë për v.2019 dhe përbën mbi 28.44 % të tërë popullsisë së Kosovës. Rajoni qendër përbën rreth 20.31 % të tërë territorit të Kosovës i cili ka një sipërfaqe prej (10,905.25 km²). Mesatarisht, në rajonin zhvillimor Qendër jetojnë afërsisht rreth 230 banorë në 1 km².

Tabela 4, të dhënat e përgjithshme të sipërfaqes dhe popullsisë në RZHQ

Nr.	Komunat	Popullsia (Vlerësimi i popullsisë 2019)	Sipërfaqja	% e territorit të komunave në rajonin qendër	Nr. vendbanimeve
1	Prishtinë	216,870	523.13 km ²	23.61 %	48
2	Podujevë	81,514	632.59 km ²	28.55 %	78
3	Lipjan	57,413	338.41 km ²	15.27 %	62
4	Obiliq	17,899	104.84 km ²	4.73 %	20
5	Glllogoc	60,525	275.63 km ²	12.44 %	37
6	Shtime	27,031	134.42 km ²	6.06 %	23
7	Fushë Kosovë	38,960	84.09 km ²	3.79 %	15
8	Graçanicë	12,186	122.41 km ²	5.52 %	16
	Gjithsej:	512,398	2,215.52 km²	/	299

¹ <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>

² <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullise-2019>

8.2 Rajoni zhvillimor Lindje përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) komuna: Ferizaj, Gjilan, Hani i Elezit, Kaçanik, Novobërdë, Shtërpçë, Viti, Klllokot, Ranillug, Kamenicë dhe Partesh. Ai kufizohet me rajonin zhvillimor qendër në anën veriore, me Serbinë në lindje, me rajonin zhvillimor Jug në anën perëndimore dhe me Maqedoninë në anën jugore.

Rajoni zhvillimor lindje ka një sipërfaqe prej 2,298.50 km²³, popullsi prej 323,154⁴ banorë sipas vlerësimit të popullsisë për v.2019 dhe përbën 18.23 % të tërë popullsisë së Kosovës (1,782,115). Rajoni zhvillimor lindje përbën rreth 21% të tërë territorit të Kosovës (10,905.25 km²). Mesatarisht, në rajonin lindje jetojnë rreth 142 banorë në 1 km². Të dhënat e rajonit zhvillimor lindje janë të dhëna të marra nga dokumenti “ Profilet e Rajoneve Rajonale në Kosovë “.

Tabela 5, të dhënat e përgjithshme të sipërfaqes dhe popullsisë të RZHL

Nr.	Komunat	Popullsia (Vlerësimi i popullsisë 2019)	Sipërfaqja	% e territorit të komunave në rajonin lindje	Nr. vendbanimeve
1	Gjilan	76,271	391.84 km ²	17.04 %	42
2	Ferizaj	105,116	344.61 km ²	14.99 %	44
3	Viti	47,507	269.69 km ²	11.73 %	38
4	Kamenicë	27,823	416.61 km ²	18.12 %	58
5	Novobërdë	7,121	203.98 km ²	8.87 %	34
6	Kaçanik	34,420	211.28 km ²	9.19 %	31
7	Hani i Elezit	10,013	83.11 km ²	3.61 %	10
8	Shtërpçë	6,670	247.70 km ²	10.77 %	16
9	Ranillug	3,785	77.62 km ²	3.37 %	13
10	Klllokot	2,702	23.39 km ²	1.01 %	4
11	Partesh	1,726	28.67 km ²	1.24 %	3
	Gjithsej	323,154	2,298.50	/	293

8.3 Rajoni zhvillimor veri është i përbërë nga shtatë komuna: Mitrovica Jugore, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtrri dhe Skenderaj. Rajoni zhvillimor veri kufizohet me Serbinë në veri, me rajonin qendër në verilindje me rajonin perëndim në perëndim.

Rajoni zhvillimor veri mbulon një sipërfaqe prej 2,051.84 km² apo 18.81 % të tërë territorit të Kosovës (10,905.25 km²)⁵. Popullsia e përgjithshme e rajonit veri është 222,472 ‘apo 12.56% e popullatës së përgjithshme të Kosovës (1,782,115). Dendësia e banoreve në rajonin zhvillimor Veri është 110 banore në një km².

³ <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>

⁴ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullise-2019>

⁵ <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>

⁶ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullise-2019>

Tabela 6, të dhënat e përgjithshme të sipërfaqes dhe popullsisë RZHV

Nr.	Komunat	Popullsia (Vlerësimi i popullsisë 2019)	Sipërfaqja	% e territorit të komunave në rajonin veri	Nr. Vendbanimeve
1	Mitrovica Jugore	68,840	331,18 km ²	16.14 %	46
2	Mitrovica Veriore	12,043	5 km ²	0.24 %	3
3	Zveçan	7,336	123,01 km ²	5.99 %	63
4	Zubin Potok	6,648	334,38 km ²	16.29 %	61
5	Skenderaj	52,372	374,37 km ²	18.24 %	49
6	Vushtrri	62,026	344,85 km ²	16.80 %	67
7	Leposaviq	13,207	539,05 km ²	26.27 %	72
	Gjithsejt	222,472	2,051.84	/	361

8.4 **Rajoni zhvillimor Perëndim** përbëhet nga gjashtë komuna: Pejë, Klinë, Istog, Junik, Deçan dhe Gjakovë. Kufizohet me Malin e zi në veriperëndim, ndërsa në jug perëndim kufizohet me Shqipërinë, në pjesën verilindore me rajonin zhvillimor ekonomik veri, dhe juglindje me rajonin jug.

Rajoni zhvillimor perëndim mbulon rreth 2,324.38 km apo 21.31% të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës (10,905.25 km²). Me një popullsi të përgjithshme prej 321,488⁷ banorë sipas vlerësimit të popullsisë për v.2019 apo afërsisht 17.99%⁸ të popullsisë së Kosovës. Dendësia e popullsisë është 139 banorë për km në rajonin Perëndim

Tabela 7, të dhënat e përgjithshme të sipërfaqes dhe popullsisë të RZHP

Komunat	Popullsia (Vlerësimi i popullsisë 2019)	Sipërfaqja	% e territorit të komunave në rajonin perëndim	Nr. vendbanimeve
Deçan	42,244	293.97 km ²	12.64 %	37
Gjakovë	93,740	586.62 km ²	25.23 %	91
Istog	40,923	454.36 km ²	19.54 %	50
Junik	6,364	77.78 km ²	3.34 %	3
Klinë	40,076	309.02 km ²	13.30 %	54
Pejë	98,141	602.63 km ²	25.92 %	79
Gjithsej	321,488	2,324.38 Km²	/	314

⁷ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2019>

⁸ <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>

8.5 Rajoni zhvillimor Jug përbëhet nga gjashtë komuna: Rahoveci, Malisheva, Prizreni, Suhareka, Dragashi dhe Mamusha. Rajoni jug shtrihet në pjesën jugperëndimore të Kosovës. Kufizohet me Shqipërinë në jugperëndim, Maqedoninë në juglindje, në lindje me rajonin zhvillimor lindje, në verilindje rajonin ekonomik qendër, në pjesën veriperëndimorë kufizohet me rajonin ekonomik perëndim.

Rajoni zhvillimor jug mbulon rreth 2,015.01 km, 18.47 % të sipërfaqes së Kosovës (10,905.25⁹ km²). Me popullsi prej 402,603¹⁰ apo 22.76 % të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Dendësia e popullsisë është 203 banorë për km katror në rajonin jug.

Tabela 8, Të dhënat e përgjithshme të sipërfaqes dhe popullsisë të RZHJ

Nr	Komunat	Popullsia(Vlerësimi i popullsisë 2019)	Sipërfaqja	% e territorit të komunave në rajonin jug	Vendbanimet
1	Prizreni	193,123	626.86 km ²	31.10 %	76
2	Suharekë	57,203	361.04 km ²	17.91 %	42
3	Rahoveci	56,414	275.90 km ²	13.69 %	35
4	Malishevë	56,046	306.42 km ²	15.20 %	43
5	Dragashi	33,983	433.85 km ²	21.53 %	35
6	Mamusha	5,834	10.94 km ²	0.54 %	0
	Gjithsej	402,603	2,015.01 km²	/	231

IX. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Qendër

Në rajonin zhvillimor qendër, kanë investuar 11 Ministri. Në kuadër të këtij rajoni, nuk ka asnjë komunë që nuk ka përfituar të paktën një projekt kapital nga një ministri e linjës.

Shuma e financimit të ministrive të linjës në këtë rajon është: 18,532,407.78 me numër të përgjithshëm të projekteve 102. Për dallim nga viti 2018, në vitin 2019 vërehet një trend i rritjes së investimeve në diferencë prej 1,091,550.40 apo 3.0%, ndërsa në numër të projekteve 9 më shumë në vitin 2019 se në vitin 2018.

Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e financimit të ministrive të linjës në rajonin zhvillimor Qendër.

⁹ <https://mzhr.rks-gov.net/publikimet/>


¹⁰ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2019>

Tabela 9, Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Qendër

Ministritë	Vlera e investimeve kapitale	Numri i projekteve	Numri i projekteve te realizuara ne komnat e rajonit zhvillimor qendër	Vlera e investimit
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2,431,710.10	12	Lipjan 3	713,186.43
			Obiliq 2	82,246.00
			Podujevë 2	549,990.23
			Shtime 1	120,000.00
			Graçanicë 1	232,749.94
			Fushë Kosovë 1	148,145.40
			Prishtinë 2	585,392.10
Ministria e Shëndetësisë	99,964.06	1	Podujevë 1	99,964.06
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	355,756.00	7	Prishtinë 1	78,060.00
			Glllogvc 2	171,395.00
			Podujevë 2	74,666.00
			Obiliq 1	20,291.46
			Lipjan 1	11,343.54
Ministria e Administratës Publike	5,371,335.99	8	Podujevë 1	971,212.13
			Glllogvc 2	1,097,726.25
			Prishtinë 5	3,302,397.61
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1,868,473.75	12	Prishtinë 1	50,000.00
			Glllogvc 1	132,798.73
			Shtime 5	867,118.97
			Podujeve 2	289,589.78
			Lipjan 3	528,966.27
Ministria e Infrastrukturës	5,411,355.29	26	Prishtinë 2	774,821.92
			Glllogvc 7	1,045,579.50
			Shtime 1	105,078.91
			Podujeve 5	797,491.82
			Lipjan 3	451,389.84
			Fushë Kosovë 2	357,785.62
Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit	1,255,000.00	18	Obiliq 6	1,879,207.68
			Prishtinë 10	745,000.00
			Glllogvc 2	60,000.00
			Fushë Kosovë 2	330,000.00
			Graçanicë 1	80,000.00
			Lipjan 1	20,000.00
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	144,998.50	1	Podujevë 2	20,000.00
			Prishtinë 1	144,998.50
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	164,660.11	1	Lipjan1	164,660.11
Ministria e Zhvillimit Rajonal	368,690.10	4	Glllogvc 2	168,690.10
			Shtime 1	100,000.00
			Obiliq 1	100,000.00
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1,060,463.88	12	Prishtinë 1	40,000.00
			Graçanicë 1	280,000.00
			Glllogvc 3	220,295.00
			Fushë Kosovë 1	55,000.00
			Shtime 1	42,705.00

			Podujevë 1	30,000.00
			Obiliq 2	120,022.74
			Lipjan 2	272,441.14
Totali i projekteve te realizuara	18,532,407.78	102	/	18,532,407.78

Graf. 3 Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Qendër



Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën nr.3 dhe grafikonin nr. 3, të paraqitur më lartë, tri (3) ministritë që kanë investuar më së shumti investime kapitale sipas rajoneve zhvillimore, gjatë vitit 2019, janë:

1. Ministria e Infrastrukturës, me total të investimeve: 5,411,355.29€
2. Ministria e Administratës Publike, me total të investimeve: 5,371,335.99€
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me total të investimeve: 2,431,710.10€

Për dallim nga viti 2018 ku kishim një renditje tjetër të ministrive që kanë investuar në këtë rajon (MKRS, MI, MASHT), në vitin 2019 prin MI (e ndjekur nga MAP dhe MMPH) gjithashtu me një rritje të investimeve të kësaj ministrie nga viti 2018 në vlerë prej 273,157.23 apo 26%.

Sektorët e investimeve ne rajonin Qendër

Në Rajonin Zhvillimor Qendër, është investuar në 13 sektorë në një shumë totale të investimeve në një shumë prej: 18,532,407.78, nga 15 sektorë sa janë gjithsejtë. Në tabelën në vijim nr. 10, paraqitën sektorët e investimeve në rajonin qendër dhe shumat e financimit.

Tabela 10, Sektorët e Investimeve ne rajonin zhvillimor Qendër

Nr.	Përshkrimi	Gjithsejtë
1.	Ndërtesat e banimit	424,998.50
2.	Objektet arsimore	3,937,412.13
3.	Ndërtesat administrative afariste	3,487,057.72
4.	Objekte shëndetësore	99,964.06
5.	Objektet kulturore	955,000.00
6.	Ndërtimi i rrugëve lokale	6,046,673.03
7.	Trotuaret	372,224.24
8.	Kanalizimi	100,000.00
9.	Ujësjellës	399,990.23
10.	Telekomunikacioni	164,069.54
11.	Efiçienca e Energjisë	191,686.46
12.	Rregullimi i lumenjve	2,028,724.97
13.	Kapital tjetër	324,606.90
Nr.	Gjithsejtë	18,532,407.78

Graf 4 Vlerat e investimeve kapitale sipas sektorëve në rajonin zhvillimor Qendër



Ashtu siç po shihet në tabelën nr.10 dhe grafikonin nr. 4, të paraqitur më lartë, në vijim po i renditim tre (3) sektorët në të cilët është investuar më së shumti gjatë vitit 2019 në rajonin qendër, janë:

1. Ndërtimi i rrugëve lokale: 6,046,673.03€;
2. Objektet arsimore: 3,937,412.13€;
3. Ndërtesat administrative, afariste: 3,487,057.72€;

Sikurse në vitin 2018 edhe në vitin 2019 prin sektori i rrugëve lokale me një ngritje prej 740,118.01€ apo 6.52%.


Vlera e investimeve të përfituara nga komunat në rajonin zhvillimor Qendër

Në kuadër të Rajonit Zhvillimor Qendër, komuna e cila ka përfituar më së shumti financim për realizimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2019 është:

- Komuna Prishtinës në shumë prej 5,720,670.13 me një numër prej 23 projekteve në total,
- Komuna e dytë është Komuna e Glogovcit në shumën prej 2,896,484.58 dhe me numër prej 19 projekteve kapitale të investuara.
- Komuna e trete është Komuna e Podujevës në vlerë prej 2,832,914.02 dhe në kuadër të kësaj vlere janë realizuar 16 projekte kapitale nga niveli qendror.

Nga të dhënat e mësipërme dhe nëse bëjmë një krahasim me investimet kapitale të vitit të kaluar (2018), shohim se Komuna e Prishtinës është Komuna liderë në rajonin zhvillimor Qendër e cila ka pranuar më së shumti investime kapitale në krahasim me Komunat tjera të këtij rajoni. Komuna e Prishtinës investimet në të mëdha i ka pranuar nga Ministria e Administratës Publike në vlerën prej 3,302,397.61€ në sektorin e objekteve administrative/afariste.

Graf. 5 financimi i komunave në rajonin zhvillimor Qendër



X. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Lindje

Në rajonin zhvillimor Lindje, kanë investuar 12 Ministri. Në kuadër të këtij rajoni, nuk ka asnjë komunë që nuk ka përfituar të paktën një projekt kapital nga një ministri e linjës.


Shuma e financimit të ministrive të linjës në këtë rajon është: 23,149,235.00 me numër të përgjithshëm të projekteve 140. Për dallim nga viti 2018, në vitin 2019 vërehet një trend i rritjes së investimeve në diferencë prej 7,564,737.15 apo 19.53%, ndër në numër të projekteve 36 më shumë në vitin 2019 se në vitin 2018. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e financimit të ministrive të linjës në rajonin zhvillimor Veri, paraqiten si në tabelën nr.5 në vijim.

Tabela 11, Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Lindje

Ministritë	Vlera e investimeve kapitale	Numri i projekteve	Numri i projekteve te realizuara ne komunitet e rajonit zhvillimor lindje	Vlera e investimit
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2,675,136.56	13	Klllokot 1	6,584.61
			Novo Bërd 1	12,472.45
			Partesh 1	79,999.99
			Kamenicë 5	1,995,308.12
			Viti 1	74,793.62
			Kaçanik 1	200,000.00
			Shtëpi 1	55,977.77
			Gjilan 2	250,000.00
Ministria e Shëndetësisë	2,517,430.18	2	Ferizaj 1	2,363,245.16
			Gjilan 1	154,185.02
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	477,633.90	12	Ferizaj 1	53,673.48
			Gjilan 2	52,478.35
			Hani i Elezit 1	66,744.34
			Kaçanik 1	40,252.29
			Viti 2	70,452.40
			Kamenicë 2	76,275.95
			Novo Bërd 3	117,757.09
Ministria e Administratës Publike	818,797.52	1	Viti 1	818,797.52
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1,613,309.88	10	Ferizaj 3	529,659.40
			Gjilan 2	38,000.00
			Kaçanik 3	701,324.59
			Kamenicë 1	94,325.89
			Viti 1	250,000.00
Ministria e Infrastrukturës	11,898,000.56	58	Ferizaj 14	7,681,019.33
			Gjilan 21	1,821,807.00
			Ranillug 1	27,325.87
			Hani i Elezit 3	367,313.57
			Kaçanik 9	682,184.55
			Viti 7	697,591.56
			Kamenicë 3	620,758.68
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	404,556.00	8	Ferizaj 2	50,000.00
			Gjilan 1	20,000.00
			Viti 1	10,000.00
			Kamenicë 3	284,556.00
			Novo Bërd 1	40,000.00
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	35,409.70	1	Kaçanik 1	35,409.70
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	516,170.77	1	Viti 1	516,170.77
Ministria e Zhvillimit Rajonal	374,463.11	6	Kamenicë 2	140,595.29
			Novo Bërd 1	13,754.62
			Viti 1	50,113.20
			Hani i Elezit 1	70,000.00
			Kaçanik 1	100,000.00
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1,139,048.68	17	Ferizaj 1	50,094.00
			Gjilan 2	354,166.00

			Ranillug 1	30,000.00
			Shtërpç 1	29,569.81
			Hani i Elezit 2	108,430.00
			Kaçanik 2	177,643.00
			Viti 2	164,601.00
			Kamenicë 1	22,476.66
			Partesh 2	80,000.00
			Klllokot 2	82,627.77
			Novo Bërdo 1	39,440.44
Ministria për komunitete dhe kthim	679,278.14	11	Gjilan 1	7,989.00
			Ranillug 4	306,767.14
			Shtërpç 2	208,295.00
			Partesh 1	61,793.00
			Novo Bërd 3	94,434.00
Totali i projekteve të realizuara	23,149,235.00	140		23,149,235.00

Graf 6, Vlera e investimeve kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Lindje



Siç po shihet në tabelën nr.5 dhe grafikun nr. 6, të paraqitur më lartë, në vijim po i renditim tri (3) ministrinë që kanë realizuar më së shumti investime kapitale në rajonet zhvillimore, gjatë vitit 2019, janë:

1. Ministria e Infrastrukturës, me total të investimit: 11,898,000.56€
2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me total të investimit: 2,675,136.56€
3. Ministria e Shëndetësisë: 2,517,430.18€

Edhe në vitin 2019 me investime në këtë rajon prin MI dhe me një rritje nga viti 2018 në vlerë prej 3,917,313.79 apo 19.7%.


Sektorët e investimeve ne rajonin zhvillimor Lindje

Në Rajonin Zhvillimor Lindje, është investuar në 14 sektorë në një shumë totale të investimeve në një shumë prej: 23,149,235.00€, nga 14 sektorë sa janë gjithsejtë. Në tabelën në vijim nr. 12, paraqitën sektorët e investimeve në rajonin qendër dhe summat e financimit.

Tabela 12, Sektorët e investimeve ne rajonin zhvillimor Lindje

Nr.	Përshkrimi	Gjithsejtë
1.	Ndërtesat e banimit	35,409.70
2.	Ndërtesat administrative afariste	516,170.77
3.	Objektet arsimore	2,454,584.00
4.	Objektet shëndetësore	2,659,475.18
5.	Objektet kulturore	434,556.00
6.	Objektet sportive	270,923.00
7.	Ndërtimi i rrugëve lokale	12,588,037.00
8.	Trotuaret	96,893.20
9.	Ujësjiellësi	927,762.28
10.	Kanalizim	655,143.77
11.	Telekomunikacioni	316,963.79
12.	Efiçienca e Energjisë	160,670.11
13.	Rregullimi i lumenjëve	19,057.35
14.	Kapital tjetër	2,013,588.85
	Gjithsejtë	23,149,235.00

Graf 7, Vlerat e investimeve kapitale sipas sektorëve në rajonin zhvillimor Lindje



Ashtu siç po shihet në tabelën nr. 12 dhe grafikonin nr. 7, të paraqitur më lartë, në vijim po i renditim tre (3) sektorët në të cilët është investuar më së shumti gjatë vitit 2019 në rajonin Lindje, janë:

1. Ndërtimi i rrugëve lokale: 12,588,037.00€;

2. Objektet shëndetësore: 2,659,475.18€;
3. Objektet arsimore: 2,454,584.00€;

Ndërtimi i rrugëve lokale është sektori më i investuar në vitin 2019 në rajonin zhvillimor lindje, ngjashëm sikurse në vitin 2018 dhe me një rritje prej 3,481,124.00 apo 16.0%.

Vlera e investimeve të përfituara nga komunat në rajonin zhvillimor Lindje


Në kuadër të Rajonit Zhvillimor Lindje, komuna e cila ka përfituar më së shumti financim për realizimin e projekteve kapitale është:

- Komuna e Ferizajt në shumë prej 10,727,691.37€ me një numër prej 22 projekteve të investurara nga niveli qendror.
- Komuna e dytë është Komuna e Kamenicës në shumë prej 3,234,296.59€ me 17 projekte të investuara, ndërsa
- Komuna e tretë është Komuna e Gjilanit me një numër prej 32 projekteve dhe në shumë prej 2,698,625.37€.

Nëse krahasojmë investimet kapitale të vitit të kaluar (2018), Komuna e Ferizajt edhe këtë vit ka pranuar investime kapitale nga Ministritë e Linjës më së shumti në krahasim me Komunat tjera të rajonit zhvillimor Lindje. Komuna Ferizajt ka një vlerë të dyfishuar të investimeve në krahasim me vitin 2018, ku investimet më të mëdha janë bërë nga Ministria e Infrastrukturës në këtë Komunë në vlerë prej 7,681,019.33 në sektorin e rrugëve lokale.

Më hollësisht, lidhur me financimin e komunave të këtij rajoni, paraqiten statistikën në grafikonin nr.8.

Graf 8, Vlera e investimeve të përfituara nga komunat në rajonin zhvillimor Lindje



XI. Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Veri

Rajoni zhvillimor i veriut është i përbërë nga shtatë (7) komuna: Mitrovica Jugore, Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtri dhe Skenderaj.

Në rajonin zhvillimor veri, kanë investuar 11 Ministri. Në kuadër të këtij rajoni, nuk ka asnjë komunë që nuk ka përfituar të paktën një projekt kapital nga një ministri e linjës.

Shuma e financimit të ministrive të linjës në këtë rajon është: 17,828,499.47 me numër të përgjithshëm të projekteve 83. Gjithashtu, edhe në këtë rajon kemi një ngritje të investimeve nga viti 2018 në vitin 2019 në shumë prej 4,914,848.32 apo 16.0% dhe me 15 projekte më shumë në vitin 2019 se në vitin 2018.


Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e financimit të ministrive të linjës në rajonin zhvillimor Veri.

Tabela 13, Investimet kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Veri

Ministritë	Vlera e investimeve kapitale	Numri i projekteve	Numri i projekteve të realizuara në komunitet e rajonit zhvillimor veri	Vlera e investimeve
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2,376,220.91	10	Mitrovica Jugore 4	1,499,953.78
			Skenderaj 5	777,167.13
			Leposaviq 1	99,100.00
Ministria e Administratës Publike	8,063,827.00	2	Mitrovica Jugore 2	8,063,827.00
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	487,200.21	11	Mitrovica Jugore 3	135,214.90
			Vushtrri 5	175,759.64
			Skenderaj 2	58,625.07
			Leposaviq 1	117,600.60
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1,788,204.13	9	Mitrovica Jugore 3	415,445.36
			Skenderaj 6	1,372,758.77
Ministria e Infrastrukturës	3,088,972.77	20	Mitrovica Jugore 3	968,376.29
			Vushtrri 2	154,415.87
			Skenderaj 13	1,431,254.84
			Leposaviq 1	34,992.00
			Zveçan 1	499,933.77
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	485,000.00	11	Mitrovica Jugore 5	300,000.00
			Vushtrri 2	45,000.00
			Skenderaj 4	140,000.00
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	709,813.50	1	Vushtrri 1	709,813.50
Ministria e Zhvillimit Rajonal	182,813.39	3	Mitrovicë Jugore 1	47,813.40
			Skenderaj 2	134,999.99
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	616,586.12	14	Mitrovica Jugore 1	60,000.00
			Mitrovica Veriore 5	258,429.13
			Vushtrri 2	58,940.00
			Skenderaj 1	50,000.00
			Leposaviq 1	49,779.00
			Zubin Potok 2	89,441.49
			Zveçan 2	49,996.50

Ministria për komunitete dhe kthim	29,861.00	2	Vushttri 2	29,861.00
Totali i projekteve te realizuara	17,828,499.03	83		17,828,499.03

Graf. 9 Vlera e investimeve kapitale sipas ministrive në rajonin zhvillimor Veri



Ashtu siç po shihet në tabelën nr.7 dhe grafikonin nr. 9, të paraqitur më lartë, në vijim po i renditim tri (3) ministritë që kanë investuar më së shumti investime kapitale në rajonet zhvillimore, gjatë vitit 2019, janë:

1. Ministria e Administratës Publike: 8,063,827.00€
2. Ministria e Infrastrukturës: 3,088,972.77€
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: 2,376,220.91€

Për dallim nga viti 2018 ku printe Ministria e Infrastrukturës (e ndjekur nga MF dhe MKRS) në vitin 2019 prin Ministria e Administratës Publike, e cila në vitin 2018 as nuk ishte në treshen e parë të investimeve në këtë rajon zhvillimor.

Sektorët e investimeve ne rajonin zhvillimor Veri


Në Rajonin zhvillimor Veri, është investuar në 12 sektorë në një shumë totale të investimeve në një shumë prej: 17,828,499.03€ , nga 15 sektorë sa janë gjithsejtë. Në tabelën në vijim nr. 14, paraqitën sektorët e investimeve në rajonin qendër dhe shumat e financimit.

Tabela 14, Sektorët e investimeve ne rajonin zhvillimor Veri

Nr.	Përshkrimi	Gjithsej
1.	Ndërtesat administrative afariste	709,813.50
2.	Objektet arsimore	9,852,031.13
3.	Objektet kulturore	485,000.00

4.	Objektet sportive	67,813.40
5.	Ndërtimi i rrugëve lokale	3,492,657.56
6.	Trotualet	364,458.95
7.	Ujësjetllësi	439,767.26
8.	Telekomunikacioni	334,827.00
9.	Efienca e Energjisë	152,374.00
10.	Mirëmbajtja investive	21,365.00
11.	Rregullimi i lumenjëve	1,716,499.87
12.	Kapital tjetër	191,891.36
	Gjithsejtë	17,828,499.03

Graf. 10 Vlerat e investimeve kapitale sipas sektorëve në rajonin zhvillimor Veri



Siç po shihet në tabelën nr.14 dhe grafikonin nr. 10, të paraqitur më lartë, në vijim po i renditim tre (3) sektorët në të cilët është investuar më së shumti gjatë vitit 2019 në rajonin Veri, janë:

1. Objektet arsimore: 9,852,031.13€ ;
2. Rrugë lokale: 3,492,657.56€
3. Rregullimi i lumenjëve: 1,716,499.87€

Në vitin 2019 kemi një ndryshim në renditje të sektorëve më të investuar në këtë rajon, ku në vitin 2018 printe sektori "Ndërtimi i rrugëve lokale", në vitin 2019 prin sektori "Objektet arsimore", i cili ishte sektori i dytë më i investuar në vitin 2018. Në vitin 2019 në këtë sektor është konstatuar një ngritje e dukshme në shumë prej 8,106,894.86 apo 69.9%.

Vlera e investimeve të përfituara nga komunat në rajonin zhvillimor Veri

Në kuadër të Rajonit Zhvillimor Veri, komuna e cila ka përfituar më së shumti financim për realizimin e projekteve kapitale në vitin 2019 është:

- Komuna e Mitrovicës Jugore në shumë prej 11,490,630.73 € me 22 projekte.
- Komuna e dytë është Komuna e Skenderajt në shumë prej 3,964,805.80 € me një numër të projekteve prej 33, ndërsa
- Komuna e tretë është Vushtrria në shumë prej 1,173,790.01€ ku janë realizuar dhe investuar 14 projekte kapitale.

